REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 396/25 Dt. 04.07.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

---

# Procesverbali i takimit të parë publik me qytetarë për raportin e punës për periudhën Janar-Qershor 2025

Takimi publik me qytetarë është organizuar nga kryetari i komunës, Shaqir Totaj, drejtorët e drejtorive komunale, ky takim është bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 92 të Statutit të Komunës së Prizrenit me Nr. 01/011-5643.

**Publikimet:**

**-Me 16.06.2025,** konform afateve ligjore janë publikuar njoftimit në webfaqen zyrtare të komunës, në platformën e konsultimeve publike si dhe në rrjetin social facebook.

Në webfaqe:

https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Njoftim-per-organizimin-e-takimit-te-pare-publik-te-kryetarit-te-komunes-Shaqir-Totaj.pdf

Njoftimi si lajm:
https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-takimit-te-pare-publik-me-qytetare-te-kryetarit-shaqir-totaj/

**Me 16.06.2025**, njoftimi (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

**Me 30.06.2025**, është mbajtur takimi publik, lajmi për mbajtjen e takimit:

Në webfaqe:

https://prizren.rks-gov.net/news/kryetari-shaqir-totaj-raportoi-per-punen-gjashtemujore-te-ekzekutivit-te-komunes-se-prizrenit/

Facebook:

https://www.facebook.com/share/p/1AtwkB6PuQ/

**Takimi ka filluar në orën:09:08**

**Ymer Berisha**-Udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun edhe për këtë takim publik, kryetari Totaj a ka kërkuar që ti respektojmë të gjitha afatet ligjore në mënyrë që të jemi sa ma transparent për gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit. Për këtë takim publik zyrtarët përgjegjës do të mbajnë procesverbal dhe raport dhe të njëjtit do të publikohen në webfaqen zyrtare të komunës, në mënyrë që të kemi të dhëna në arkivë dhe se kudo që kemi nevojë të shohim se çka është diskutuar në takimet publike.

**Shaqir Totaj**-Kryetar i komunës së Prizrenit në hapje të takimit ka thënë se teksa përmbyllim gjysmën e parë të vitit 2025, ndihem thellësisht mirënjohës për mbështetjen dhe besimin tuaj të vazhdueshëm në punën që po bëjmë së bashku për ta zhvilluar dhe përmirësuar Komunën e Prizrenit. Ky rrugëtim që e nisëm para katër vitesh është shoqëruar me sfida, por mbi të gjitha me arritje konkrete dhe të prekshme në jetën e përditshme të qytetarëve tanë.

Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar projekte të rëndësishme infrastrukturore në të gjitha zonat e komunës, me theks të veçantë në rregullimin e infrastrukturës në lagjen Bazhdarhane, krijimin e hapësirave publike cilësore, përfshirë rehabilitimin e Shadërvanit, si dhe lirimin e shumë hapësirave të bllokuara më parë, duke mundësuar frymëmarrje të lirë për qytetin dhe qasje të barabartë për të gjithë.

Ngjarjet kulturore dhe ato sportive janë bërë tashmë pjesë e pandashme e jetës së qytetit tonë. Festivale, aktivitete për të rinjtë dhe mbështetje për klubet sportive po e kthejnë Prizrenin në një qendër dinamike dhe të gjallë, jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë.

Në të njëjtën kohë, kemi forcuar mekanizmat e transparencës dhe llogaridhënies në çdo nivel institucional. Komuna e Prizrenit ka shënuar përmirësim të vazhdueshëm në të gjitha vlerësimet e organizatave që matin transparencën komunale, duke dëshmuar angazhimin tonë për t'u shërbyer qytetarëve me përgjegjësi dhe ndershmëri.

Të gjitha këto arritje janë rezultat i një pune të përbashkët dhe përkushtimi të pandërprerë për ta bërë Prizrenin një vend më të mirë për të jetuar. Ne kemi vendosur standarde të reja për zhvillimin lokal dhe kemi hedhur themele të forta për projekte të reja në muajt në vijim.

Faleminderit për besimin dhe partneritetin tuaj. Bashkë do të vazhdojmë të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për qytetin tonë.

Prizreni në punë!

**Zyra e Kryetarit-Raporti Janar-Qershor 2025**

Zyra e Kryetarit ka udhëhequr koordinimin e qeverisjes komunale, me fokus në bashkëpunimin institucional, komunikimin me qytetarët dhe forcimin e partneriteteve.

**Takimet dhe koordinimi**
Janë mbajtur takime të rregullta me drejtoritë komunale për të ndjekur zbatimin e planit të punës dhe adresimin e sfidave në kohë.

**Bashkëpunimi ndërkombëtar**
Kemi pritur ambasadorë nga vende partnere si Gjermania, Turqia, BE-ja dhe Franca, për të thelluar marrëdhëniet dhe mundësitë për zhvillim.

**Partneritetet institucionale dhe shoqëria civile**
Zyra ka bashkëpunuar me KFOR-in, UNDP-në, GIZ-in, organizata të komuniteteve dhe OJQ-të në fusha të ndryshme të interesit publik.

**Marrëveshje bashkëpunimi**
Janë nënshkruar 17 marrëveshje me institucione dhe organizata si GIZ, DEMOS, Caritas, Policia e Kosovës dhe fondacione humanitare, për projekte që ndikojnë drejtpërdrejt në qytetarë.

**Kërkesat e qytetarëve**
Janë trajtuar mbi 100 kërkesa të adresuara nga qytetarë, organizata dhe biznese, të cilat janë përcjellë për zgjidhje në drejtoritë përkatëse.

**Pjesëmarrje në publik**
Kryetari ka marrë pjesë në aktivitete kulturore, sportive dhe zhvillimore, si dhe në inaugurime projektesh për përmirësimin e jetës së qytetarëve.

**1. Zyra për Komunikim me Publikun**

Gjatë këtij gjashtëmujori, Zyra ka siguruar publikimin në kohë të të gjitha dokumenteve zyrtare në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës. Janë organizuar 7 takime publike në kuadër të buxhetimit me pjesëmarrje. Prizreni është shpërblyer me grantin e performancës (2 milionë euro) dhe është radhitur e para për transparencë sipas KDI-së. Janë trajtuar 57 kërkesa për qasje në dokumente publike.

**2. Zyra e Prokurimit**

Janë shpallur 103 tenderë dhe janë nënshkruar 65 kontrata për punë dhe shërbime, përfshirë edhe projekte të bartura nga viti 2024. Janë përmbyllur 5 aneks-kontrata dhe janë në proces 38 dosje të reja. Janë regjistruar 8 lëndë në ankimim.

**3. Zyra për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore**

Janë pranuar 902 kërkesa dhe janë zhvilluar 45 konkurse për vende pune në administratë, shëndetësi, arsim dhe sektorin teknik. Shumica e konkurseve janë në procedurë, disa kanë përfunduar me sukses, ndërsa një pjesë ka dështuar për mungesë kandidatësh.

**4. Zyra Ligjore**

Janë hartuar 258 vendime dhe 5 autorizime në përputhje me afatet ligjore. Zyra ka mbështetur procesin vendimmarrës të Kryetarit përmes dokumenteve të përgatitura me korrektësi ligjore.

**5. Zyra e Përfaqësuesit Ligjor**

Janë përfaqësuar mbi 100 lëndë gjyqësore, janë dhënë mbi 80 përgjigje ndaj padive dhe janë mbrojtur interesat e Komunës në mbi 140 seanca gjyqësore, me shumicën e rasteve të fituara.

**6. Zyra për Çështje Pronësoro-Juridike**

Janë trajtuar lëndë për shpronësime, qira, uzurpime dhe statusin juridik të pronës komunale. Zyra ka bashkëpunuar ngushtë me drejtoritë përkatëse dhe institucionet për trajtim efikas të rasteve.

**7. Zyra e Auditimit të Brendshëm**

Janë kryer 6 auditime dhe 2 rishikime të rekomandimeve. Fokus ka qenë menaxhimi i pasurisë, subvencioneve dhe të hyrave komunale. Zyra ka bashkëpunuar me ZKA dhe ka mbajtur takime të rregullta me Komitetin e Auditimit.

**8. Zyra për Integrime Evropiane**

Është koordinuar zbatimi i MSA-së dhe pjesëmarrja në projektet e Këshillit të Evropës. Zyra ka kontribuar në qeverisje të hapur dhe ka ndjekur trendet migratore pas liberalizimit të vizave.

**9. Zyra për Komunitete dhe Kthim**

Janë shpërndarë ndihma për komunitetet minoritare, janë trajtuar kërkesa për kthim dhe riintegrim, dhe është mbajtur bashkëpunim me organizata si OSBE, UNHCR dhe IOM. Janë dhënë 306 vërtetime për trajtim jashtë vendit dhe është siguruar përfaqësim i barabartë për të gjitha komunitetet.

## Drejtoria e Shërbimeve Publike

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, Drejtoria e Shërbimeve Publike ka vazhduar me realizimin e projekteve infrastrukturore të planifikuara, përfshirë projekte të bartura nga vitet paraprake dhe projekte të reja në realizim.

**Gjatë kësaj periudhe:**

· Janë nënshkruar **10 kontrata të reja** në vlerë mbi **11.4 milionë euro.** Janë shpenzuar rreth **8.4 milionë euro** për investime kapitale dhe **2.7 milionë euro** për mallra dhe shërbime. Janë zhvilluar procedura për mbi **10 projekte të reja**, dhe janë marrë **10 vendime për fillimin e procedurave.**

**Disa prej projektet më të rëndësishme në realizim ose të përfunduara infrastrukturore:**

·Ndërtimi i rrugës tranzitore (kryqëzim me autostradën) – **projekt dyvjeçar**. Rehabilitimi i rrugës "Nëna Terezë" dhe rrjetit të ujësjellësit – **projekt dyvjeçar**. Ndërtimi i kanalizimit dhe mureve mbrojtëse në Krushë e Vogël – **projekt dyvjeçar**. Rehabilitimi i hapësirave publike në pjesën e vjetër të qytetit – **dy projekte: një dyvjeçar dhe një trevjeçar.** Ndërtimi i rrugës Shuaip Spahiu **-Projekt dyvjeçar**. Ndërtimi i rrugës alternative Skorrobisht–Lubizhdë. Ndërtimi i infrastrukturës në: **Jabllanicë, Grazhdanik, Korishë, Kobajë, Romajë, Tusus, Gjonaj, Lubizhdë, Dardania 2 (Lot 1–3), zona "11 Marsi"**. Ndërtimi i rrugës Billushë – Zhur – **projekt dyvjeçar**. Ndërtimi i kanalizimit dhe rrugëve në Skorrobisht-**projekt dyvjeçar**. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Zhur dhe Lubizhdë. Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në disa zona urbane dhe rurale. Ndërtimi i rrugës me asfalt dhe murit mbrojtës në Manastiricë **-projekt trevjeçar**. Ndërtimi i rrugës te shkolla në Novosellan. Ndërtimi me kalldrëm i rrugës te kulla në Jeshkovë – **projekt dyvjeçar**. Ndërtimi i infrastrukturës në lagjen e re te shkolla në Dardani. Ndërtimi i rrugës dhe kanalizimit në lagjen Ortakoll, rr. Ali Hadri, Hajdar Shala, Marie Shllaku, Faik Konica, Rexhep Kukaj etj.

**Ndërtimi i urave dhe mure mbrojtëse:**

Urat në Poslisht, Velezhë (dy ura) dhe Korishë – **në përfundim e sipër**. Mure mbrojtëse të përfunduara në 20 lokalitete, përfshirë: Pllanjanë, Billushë, Korishë, Skorrobisht, Gërnçar, Poslisht, Bajram Curr, Neprogosht, Landovicë, Jeshkovë, Shatërvan, Malësi e Vrrinit, Reqan, Krushë e Madhe, Leskovec, etj.

**Projekte të tjera të realizuara:**

·Instalimi dhe riparimi i ndriçimit publik në mbi 16 rrugë dhe 151 lokacione. Piketimet dhe matjet gjeodezike në terren sipas kërkesave të drejtorive. Legalizimi i 134 objekteve në bazë të vendimeve të Drejtorisë së Urbanizmit

**Sektori i Menaxhimit të Mjedisit dhe Mbeturinave**

Sektori i Menaxhimit të Mjedisit dhe Mbeturinave ka implementuar kontrata për:

·Menaxhimin e mbeturinave (grumbullim, transport dhe deponim). Riparim dhe mirëmbajtje të rrugëve në zonat I, II dhe III. Pastrim të pikave ilegale të mbeturinave – **80 ton të grumbulluara**. Ndërtimi dhe rehabilitimi i miniparqeve në Lakuriq, Bazhdarhane, Ortakoll. Ndërtimi i shtratit të Lumbardhit – **projekt trevjeçar**. Mbjellja e 1,100 drunjve dekorativë, 2,200 shkurreve dhe barishtje në 3,400 m². Krasitja e 223 drunjve dhe prerja e drunjve të tharë në zona të ndryshme urbane.

Drejtoria e Shërbimeve Publike ka realizuar një volum të madh pune gjatë periudhës janar–qershor 2025, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e infrastrukturës, mjedisit dhe kushteve të jetesës në Komunën e Prizrenit. Realizimi i projekteve të planifikuara ka qenë në përputhje me objektivat strategjike dhe me përkushtim të plotë për shërbim cilësor ndaj qytetarëve.

## Drejtoria e Administratës

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria e Administratës ka realizuar disa aktivitete të rëndësishme si: përurimi i Varrezave të Martirëve në Krushë të Vogël, blerja e 7 veturave të reja për Komunën, furnizimi me lëndë djegëse për institucionet komunale dhe mbështetja e aktiviteteve përkujtimore dhe të organizatave të dala nga lufta. Po ashtu, ka filluar ekzekutimi i pagesave për kryetarët e bashkësive lokale.

**Gjendja Civile** ka lëshuar mbi 66 mijë certifikata dhe ka trajtuar mbi 2,700 procedura zyrtare.

**Sektori i IT-së** ka realizuar mbi 450 intervenime teknike, përfshirë mirëmbajtje të pajisjeve, konfigurime të reja dhe përditësime në platformat komunale.

**Zyra për Barazi Gjinore** ka organizuar trajnime dhe ka lansuar gazetën "Barazia në Fokus", si platformë informimi dhe promovimi të barazisë gjinore në nivel lokal.

## Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri

Drejtoria ka përforcuar kapacitetet e Shërbimit të Zjarrfikësve përmes blerjes së pajisjeve operative, uniformave të reja dhe një droni për monitorim të zonave të rrezikuara. Në proces janë projektet për zgjerimin e sistemit të kamerave të sigurisë dhe ndërtimin e mureve mbrojtëse në zona të ndjeshme nga rrëshqitjet e dheut.

**Statistikat për periudhën janar–qershor:**

588 intervenime për shuarje zjarresh, 155 intervenime teknike në raste aksidentesh apo ndihma të tjera, Inspektime dhe verifikime teknike në objekte publike e private.

Inspektorët e Preventivës kanë kryer 24 pëlqime sigurie dhe disa hulumtime teknike në terren, duke vazhduar angazhimin për siguri publike dhe parandalim të rrezikut.

## DREJTORIA PËR EKONOMI DHE FINANCA

Drejtoria për Ekonomi dhe Financa është përgjegjëse për planifikimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e resurseve financiare të Komunës së Prizrenit. Struktura organizative e kësaj drejtorie përbëhet nga katër sektorë:

1. Sektori për Buxhet dhe Thesar

2. Sektori i Financave

3. Sektori për Tatim në Pronë

4. Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve

**BUXHET DHE THESAR – JANAR – MAJ 2025**

| | |
|---|---|
| Pagesat e ekzekutuara | **1420** |
| Zotimet e bëra për pagesë | **758** |
| Pranimi i mallit në SIMFK | **779** |
| Aprovimi i lëndëve për mjetet e zotuara dhe të pranimit të mallit | **2489** |

Ky sektor ka pasur angazhim të vazhdueshëm në realizimin e pagesave, pranimin e mallit dhe menaxhimin e zotimeve në sistemin financiar SIMFK.

TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE SIPAS DREJTORIVE PËR PERIUDHEN JANAR – MAJ 2025

| Kodi | Drejtorit | Planifikimi | Të Hyrat | Diferenca | Indexi |
|---|---|---|---|---|---|
| 16310 | Administrata dhe Personeli | 475,000.00 | 163,125.52 | -311,874.48 | 34.34% |
| 16619 | Inspekcioni | 40,000.00 | 13,393.70 | -26,606.30 | 33.48% |
| 17510 | Ekonomi,Financ dhe Zhvillim | 3,100,777.00 | 1,548,861.62 | -1,551,915.38 | 49.95% |
| 18010 | Shërbime Publike,Mbrojtje civile, emergjenca | 3,615,000.00 | 1,789,257.96 | -1,825,742.04 | 49.49% |
| 47010 | Bujqsi,Pylltari dhe Zhvillim Rural | 0.00 | 17,335.28 | 17,335.28 | 0.00% |
| 65050 | Katastër dhe Gjeodezia | 470,000.00 | 117,610.00 | -352,390.00 | 25.02% |
| 66055 | Planifikim Urban dhe Mjesdisi | 2,190,000.00 | 778,140.86 | -1,411,859.14 | 35.53% |
| 73600 | Shërbimet e kujdesit primar Shëndetsor | 230,000.00 | 116,592.30 | -113,407.70 | 50.69% |
| 85010 | Kultur, Rini, Sport | 10,000.00 | 1,415.20 | -8,584.80 | 14.15% |
| 92050 | Arsimi dhe Shkencë-Administrata | 470,000.00 | 105,121.00 | -364,879.00 | 22.36% |
| | Gjithësej | 10,600,777.00 | 4,650,853.44 | -5,949,923.56 | 43.87% |

Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar – Maj 2025 është siç shihet edhe në tabelën e prezentuar më lartë: Për vitin 2025 janë panifikura të hyra 10,600,777.00 € kurse për këtë perudhë janë mbledhur të hyra vetanake 4,650,853.44 € apo 43.87 % nga planifikimi.

RAPORTI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE – JANAR – MAJ 2025

**Drejtoria për Buxhet dhe Financa**

| Shpenzimet sipas Kategorive | | periudha 01.01.2025-31.05.2025 | | |
|---|---|---|---|---|
| Kategoria | Planifikimi | Shpenzimet | Diferenca | Indexi (%) |

- Qendra për Regjistrimin e Bizneseve

Gjatë kësaj periudhe, janë realizuar **439 regjistrime të reja të bizneseve**, **288 ndryshime** dhe **42 shuarje**. Janë lëshuar gjithashtu **45 duplikate**, **28 vërtetime** dhe **42 ndërrime të çertifikatës**

(NUI). Qendra ka trajtuar gjithsej **345 kërkesa për informata mbi bizneset**, duke vazhduar ofrimin efikas të shërbimeve për komunitetin e biznesit.

- Tatimi në Pronë

Sektori ka shtypur dhe shpërndarë **33,757 fatura**, duke arkëtuar gjithsej **1,548,861.62 euro** nga tatimi në pronë. Janë regjistruar **1,407 objekte të reja** dhe janë verifikuar **3,833 objekte ekzistuese**. Janë pranuar **499 ankesa** për pronën e paluajtshme. Sektori ka qenë aktiv edhe në **përmirësimin e të dhënave kadastrale** dhe ofrimin e shërbimeve të përhershme për tatimpaguesit.

## DREJTORIA E INSPEKTORATEVE

Drejtoria e Inspektorateve ka vazhduar mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe rregulloreve komunale përmes sektorëve funksionalë:

Sektori i Tregut

• Inspektuar mbi **620 biznese** në qytet dhe periferi. Fokus në kontrollin e çmimeve, cilësisë së produkteve, deklaracioneve në gjuhën shqipe, dhe vendosjen e flamujve të origjinës. Janë asgjësuar produkte të pasigurta me vlerë mbi **58,000 €**. Bashkëpunim me Policinë dhe Prokurorinë për inspektime të ndjeshme. Janë trajtuar **12 ankesa** të konsumatorëve dhe janë kontrolluar mbi **100 biznese** për shitje të ndaluar për të miturit.

Sektori i Ndërtimit

• Inspektime të bizneseve ndërtimore dhe prodhuesve të materialeve.
• Verifikim i dokumentacionit ligjor, cilësisë së produkteve dhe kushteve të sigurisë në vendpunime.

Sektori Komunal

•Mbikëqyrje mbi pastrimin dhe menaxhimin e mbeturinave. Kontroll i ndotjes akustike dhe funksionimit të bizneseve në hapësira publike. Inspektime të transportit publik dhe mallrave në bashkëpunim me inspektorin e komunikacionit.

Inspektorët kanë vepruar në përputhje me ligjin dhe me përkushtim për të garantuar **siguri, pastërti dhe mbrojtje të konsumatorit**, duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e jetës në Komunën e Prizrenit.

## DREJTORIA E SHËNDETËSISË

**Investime kapitale në vazhdim:**

· Ndërtimi i QKMF-së (te ish-Kampi i KFOR-it) dhe QMF-së në Tusuz. Inicimi i projekteve për ndërtimin e ambulancave në Vlashnje dhe Randobravë, furnizimi me autoambulanca, pajisje mjekësore dhe blerja e mamografit (kontratë e nënshkruar).

**Furnizime dhe shërbime:**

· Blerje reagencash laboratorike, RTG, barna, pajisje administrative e sanitare. Trajnime për stafin shëndetësor për avancimin e shërbimeve.

**Shërbime shëndetësore të ofruara:**

· Rreth **385,875 shërbime** në QKMF, përfshirë vaksinime, analiza, RTG, shërbime urgjente, vizita në shtëpi, EKG, injeksione, këshillime etj.

**Aktivitete edukative dhe promovuese:**

· Shënimi i Ditëve Botërore të Shëndetit me aktivitete në shkolla dhe sheshe publike.

**Subvencione për raste sociale:**

· **832 kërkesa**, prej të cilave **434 janë paguar** me një total prej **173,600 €**.

**Vizita monitoruese dhe donacione:**

· Vizita në qendra shëndetësore dhe përurimi i donacionit nga Ambasada e Bullgarisë në Reqan.

## DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

**Objektivat e arritura:**

· Rritja e prodhimit dhe konkurrueshmërisë bujqësore.

· Mbështetje financiare për fermerë dhe zhvillim i zonave rurale.

**Projekte kapitale dhe shërbime:**

· Rehabilitimi i kanaleve ujitëse dhe rrugëve fushore. Ndërtimi i strehimores për qen endacak. Subvencione për ngritjen e pemishteve dhe stallave për bagëti.

**Shërbime:**

Trajtimi i qenve endacak, vaksinimi i deleve dhe inseminimi artificial i lopëve.

**Aplikime dhe bashkëpunime: 1,171 aplikime** për pagesa direkte përmes MBPZHR–AZHB. Trajnime për fermerë dhe praktikë profesionale për studentët e Agrobiznesit. Pjesëmarrje në panaire dhe bashkëpunim me institucione vendore e qendrore.

## DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Projektet kryesore në realizim

**Rehabilitimi i kulmeve dhe koridoreve në objektet kolektive të banimit** – Lista e objekteve është përzgjedhur dhe punimet janë në fazën e ekzekutimit. Qëllimi është përmirësimi i kushteve të jetesës dhe imazhit urban në lagjet me ndërtesa kolektive.

**Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK)** – Është përmbyllur faza e diskutimit publik për Profilin Urban, dhe procesi po zhvillohet sipas udhëzimeve ligjore.

**Hartimi i Planit Rregullues Urban për Zonën e Veçantë – Parku i Biznesit** – Plani ka kaluar të gjitha fazat teknike dhe është në proces miratimi përfundimtar.

**Lëndët e trajtuara në sektorin e Urbanizmit:** Lëndë të pranuara: **586.** Kërkesa të miratuara: **228.** Kërkesa të refuzuara: **33.** Kërkesa të hedhura poshtë: **13.** Procedura të pezulluara: **6.** Lëndë në procedurë: **181.** Deklarata, vërtetime dhe shkresa të ndryshme: **50.** Njoftime: **60.** Qasje në dokumente zyrtare: **11.** Ankesa të dërguara në MMPH: **4**

**Legalizimet :**

Legalizime të përfunduara: **134**. Kërkesa në shqyrtim: **154**. Lista e pritjes: **19**. Lista e rrënimit: **0**

## DREJTORIA E ARSIMIT

**Aktivitetet kryesore:**

Trajnim 7-ditor për drejtorët e shkollave me programe të akredituara nga MASHTI. Punëtori mbi buxhetimin gjinor dhe studim profesional i gjendjes në shkolla. Racionalizimi i rrjetit të klasave për menaxhim më efikas. Zbatimi i Strategjisë për Siguri në Institucionet Arsimore. Përmirësimi i ambienteve shkollore dhe pajisja me sallat e edukatës fizike dhe terrene sportive. Fuqizimi i modelit "komuniteti i të mësuarit së bashku" dhe aktivitete jashtëkurrikulare. Furnizim me mjete TIK dhe pajisje laboratorike, trajnime për nxënës në IT dhe gjuhë të huaja. Rritja e mbështetjes për fëmijët me nevoja të veçanta dhe funksionalizimi i qendrave për edukim të hershëm. Organizim trajnimesh për mbi 500 mësimdhënës në fusha të ndryshme.

**Projektet infrastrukturore dhe kapitale:**

· 27 projekte kapitale me vlerë totale 2.49 milionë euro, përfshirë ndërtimin e çerdheve në Tusus, Zhur, Arbana dhe objekteve shkollore në Mazrrek, Krushë të Vogël, Vërmicë dhe Lutogllavë.

Renovime të objekteve shkollore dhe përmirësime të ambienteve sportive. Digjitalizimi i institucioneve arsimore me pajisje teknologjike moderne. Deri më 31 maj, janë realizuar pagesa prej 851,067 euro (34.22% e buxhetit të projekteve).

**Shërbimet e ofruara dhe statistikat:**

·Në vitin shkollor 2024/25, 25,882 nxënës ndjekin mësimin në institucionet publike të komunës. Organizim i testeve të rëndësishme: PISA 2025, testi i arritshmërisë dhe i maturës. Kontroll dhe mbikëqyrje në shkolla për dokumentacion dhe mjedis gjithëpërfshirës. Promovim i multikulturalizmit dhe përfshirja e komuniteteve.

**Bashkëpunimet dhe aktivitetet shtesë:**

·Punëtori dhe takime mbi të drejtat e fëmijëve dhe komunitetin Romë-Ashkali-Egjiptian. Bashkëpunim i ngushtë me prindër dhe ekipe për parandalimin e braktisjes së shkollës. Monitorim i funksionimit të mjeteve teknologjike në shkolla.

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

**Projektet e kryera dhe në vazhdimësi:**

**Investimet kapitale:**

1. Fillimi i punimeve për ndërtimin e objekteve kulturore, rinore dhe sportive.
2. Vazhdimi i ndërtimit të qendrës kulturore në fshatin Pousk.
3. Proces i vazhdueshëm i inventarizimit të objekteve kulturore, rinore dhe sportive me furnizimin e materialeve të nevojshme.
4. Përfundimi i pagesave të mbështetjes subvencionuese të mbetura nga viti 2024 brenda tremujorit të parë.
5. Fillimi zyrtar i punimeve për renovimin e Bibliotekës së Qytetit të Prizrenit pas përfundimit të vlerësimit të tenderit.
6. Punimet në Sallën Multifunksionale janë në fazën përfundimtare.
7. Vazhdimi i mbikëqyrjes së projekteve kapitale në përputhje me investimet.
8. Punimet në Qendrën Turke janë në zhvillim e sipër.
9. Përfundimi i procedurave tenderuese për renovimin e Qendrës Sportive "Sezai Surroi" (izolimi i jashtëm dhe dritaret); fillimi i punimeve pritet së shpejti.
10. Projekti i restaurimit të Kullës në Gjonaj është në fazën përfundimtare.
11. Fillimi i punimeve për renovimin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Zhur.
12. Nisja e procedurave për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Piranë.
13. Nisja e procedurave për ndërtimin e Sallës së Mundjes në Tusuz.
14. Nisja e procedurave për ndërtimin e Palestrës Sportive në Qendrën Sportive.
15. Kryerja e barkodimit të disa aseteve të inventarizimit në DKRS.

**Aktivitetet:**

16. Vazhdimi i monitorimit të OJQ-ve kulturore, rinore dhe sportive sipas planifikimit.

17. Përfundimi i fazës së parë të mbështetjes financiare për OJQ-të kulturore, rinore dhe sportive me vlerë totale prej 1,340,800 €.
18. Vazhdimi i pagesave për marrëveshjen me eko-regjionin.
19. Organizimi i festës për 17 shkurtin – përvjetori i pavarësisë së Kosovës.
20. Organizimi i festivalit për fëmijë "Fluturat 2025" më 1 Qershor.
21. Organizimi i Festivalit Folklorik për Fëmijë "URA 2025" më 8 dhe 9 Qershor.
22. Organizimi i festave për 10 Qershorin (LSHP) dhe 12 Qershorin (Dita e Çlirimit të Prizrenit) – në format të ngjashëm.

## 11. Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- **Projektet kryesore:**
  - Vazhdon ndërtimi i banesave sociale në Lagjen Petrovë (Kulla 3 dhe 4).
  - Furnizim me inventar për Shtëpinë e të Moshuarve (në fazë tenderimi).
  - Përfundimi i ndërtimit të Qendrës për Punë Sociale 2 (QPS 2).
  - Nisje e projekteve për ndërtimin e kulmeve për familjet në nevojë dhe shtëpisë emergjente për mbrojtjen e fëmijëve.
  - Furnizime për shtëpitë komunitare për persona me aftësi të kufizuara.
  - Mbuluar shpenzimet e varrimit në bashkëpunim me institucionet përkatëse.
- **Subvencionet:**
  - Mbështetje për 21 OJQ sociale me mbi 100,000 euro.
  - Pagesa për familjet strehuese dhe në vështirësi për qira.
  - Pagim për 645 familje nënave që kanë lindur në vitin 2024.
- **Memorandume bashkëpunimi:**
  - Projekte të vazhdueshme me Terre des Hommes dhe OJQ Concordia për mbrojtjen dhe fuqizimin e komuniteteve në nevojë.
- **Qendra për Punë Sociale:**
  - Gjatë Janar-Maj 2025 janë verifikuar mbi 2,500 raste të reja.
  - 596 familje me 2,031 anëtarë përfitojnë nga asistenca sociale.

## Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik

- **Projektet dhe investimet kryesore:**
  - Përurimi i destinacionit turistik në fshatin Poslisht më 14 maj 2025.
  - Hapja e rrugës 1.2 km në Skorobisht më 21 maj 2025.
  - Fillimi i ndërtimit të objektit administrativ për zejtarët Esnaf më 21 mars 2025.
  - Vazhdimi i hapjes së rrugëve malore në Gurrin e Kallugjerit.
  - Kontrata për hapjen e rrugës malore drejt Murrademit (fshati Vlashnje).
  - Kontratë për vazhdimin e rrugës ekzistuese në fshatin Zhur.
  - Investime në rregullimin e dy burimeve të ujit në Vërmicë.
- **Aktivitetet kryesore:**
  - Trajnime falas për 48 persona në modelim, qëndisje, punë me dru dhe dekorime.
  - Trajnime në zanatin tradicional filigran për rreth 30 të rinj dhe të reja.
  - Organizim dhe pjesëmarrje aktive në panaire lokale dhe ndërkombëtare.
  - Promovim i komunës në panairin "Colors of the World" në Turqi për herë të parë.

**13. Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit**

- **Statistikat e kërkesave:**
  - Gjithsej 10,732 kërkesa të trajtuara.
  - 9,419 kërkesa të miratuara, 1,085 në proces, 142 refuzuar, 60 pezulluar.
  - Të hyrat e grumbulluara: 127,092 euro (27.04% e të hyrave të drejtorisë).
  - Ulje e të hyrave për shkak të ndryshimit të tarifave kadastrale nga AKK në qershor.
- **Aktivitete kryesore:**
  - Legalizimi: 134 vendime për ndërtimet pa leje të evidentuara në regjistrat kadastralë.
  - Kryerje piketimesh për rrugë, objekte komunale dhe hapësira publike.
  - Matje gjeodezike për incizime gjendjesh faktike dhe projekte sipas kërkesave të drejtorive.
- **Përmbledhje:**
  - Drejtoria ka funksionuar me sukses duke përmbushur kërkesat dhe realizuar aktivitete të rëndësishme për evidencën kadastrale dhe urbanistike.

**Komentet e qytetarëve:**

**Allmir Bajrami-**I nderuar kryetar ne vitin 2023 ne takimin e mbajtur ne shkolle,me keni premtuar se rampa do te hiqet ne rrugen nacionale,pyetja e 2 per Cele Lamaj ne lidhjen me pagesen e mbeturinave,banoret jane te shqetesuar ne lidhje me pagesen e mbeturinave,nuk munden me pagu 3 here me shume banoret e prevalles dhe ata qe jane me Villa,bile 3 muaj Villat punojne aty,te gjithe jane banore te Kosoves.

Si dhe rruga ne Gornjoselle eshte ende e pa asfaltuar si dhe a ka dhene leje dikush per Baraken qe e ka ndertu ne parkun Nacional e cila eshte ne token e Komunes se Prizrenit.Pyetja per drejtorin Edinit kerkojme te kemi 1 dhome per takim me qytetaret e Zhupes,dhoma ku ka qene policia ne Zhup te na jepet neve.Per drejtorin e shendetesise kam lavdata mirepo eshte mire te kujdestarohet qendra e mjekesise familjare te shtunen bile 80% ne Prevalle vijne njerez te semure sidomos gjate fluksit te veres i duhet shendetesia.

**Shaqri Totaj-**Faleminderit per Amirin, pom kujtohet per rampen qe i kam premtuar mirepo nuk e kam dit qe egziston hala,a është ne rrugën kryesore ne kemi tentu dhe i kemi shkru ministrise me na i kthy kompetencat mbi Prevallen mirepo ministria nuk na i ka kthy kompetencat.Rruga per Prevalle eshte kompetence e ministrise jo e komunes.Gjithsesi faleminderit!

**Cele Lamaj-**Inkasimi i mbeturinave ne Prevalle derisa menaxhohet prej ministrise se mjedisit dhe planifikimit hapesinor komuna e Prizrenit nuk e ka asnje detyrim ligjor per kete hapesire.Une e di se Eko regjioni per shkak te humanizmit shkon dhe bene pastrimin nuk e kane lene krejt ne doren e tyre.Ne momentin qe komuna ka mundesi buxhetore gjate vitit 2026 do te zhvillohet nje infrastrukture e nevojshme.

**Imer Hoxha-**Kam qene kryetar i fshatit 8 vite ne Malesi te Re,jane bere ivestime..kemi nje problem te fshatit 45 vjeqar sistemi i rrjetit energjetik qe 45 vite nuk eshte investu,kur te vijne

mergata para vitit te ri ska rryme.Para vitit te ri eshte ndale ndriqimi publik,qe 6 muaj ska ndriqim publik ne Malesi te Re.Nje kerkese per drejtorine e Arsimit per nataliteti i nxenesve ka rene,shkolla ka pas 4 a 5 dhoma.Ne momentin kur mbyllet shkolla punedhenesi dhe punemarresi akreditohen ne mes veti dhe i jep kushtet ti ke me kry kete pune per 3 muaj edhe pike.Nje ceshtje tjeter madhore eshte falsifiku nje prone ne qendren e fshatit Kadri Hisen Rexhaj,as bashkesia islame e as kishat nuk kane te drejte me shit nje toke po ju garantoj qe ajo prone ska qene kurr ne emer te Kadri Hysenit.

**Shaqir Totaj**-Përgjigja është shume e thjeshte,nuk ka pare me teper.Deri me tani kemi punu ne disa lokacione,qaq kemi pas mundesi mirepo ne periudhen e ardhshme ju kthehemi lokacioneve qe nuk kemi punu deri me tash,Qeveria qendrore qaq na jep buxhet perndryshe te falsifikimi i prones e angazhoj Senxharin mu marr me ate ceshtje,me siguri ne aspektin ligjor e jep nje spjegim.

**Bajrame Tafallari**-Pershendetje për te gjithë si dhe nje falenderim per mediat.Thuhet se eshte bere shume ne arsim se nxenesit po vijne ne shkolle te mesme pa dit shkrim e lexim...ku eshte drejtoresha ajo merr pjese veq ne darka dhe manifestime te shkollave.Une kam nje projekt per nxenesit qe nuk din shkrim dhe lexim dhe e ofroj ne shtator qe ta marrin kete projekt per nxenesit qe nuk din shkrim dhe lexim.

Tash me kryetarin i cili i paska realizu krejt,ne Struzhe nuk e ka realizu premtimin qe oborri i shkolles eshte ndare ne 2 pjese dhe eshte dashte te renovohet muri dhe te rrafshohet shkolla ku katundaret e mi e festojne pervjetorin e qendrimit bashke me te afermit e tyre.Ne lidhje me Tusuzin kurgjo nuk eshte investu,rruga ka mbetur e njejta,kurre nuk eshte pastru nga bora ajo rruge duhet te shtrohet me asfalt.Ne struzhe nuk e di pse nuk ndertohen villa eshte vend i pershtatshem per turizem sidomos per skijim

**Pranver Asllani**-Përshëndetje, falënderoj kryetarin qe e kemi shembull.Kur e paaramendoj qeverisje e Haskukes si ka qene dhe kjo qeverisje eshte jashtzakonisht e meritume me kete kryetar. Kam 2 kerkesa:

Me bere nje kujdestari ne ambulanten tone gjate te shtunave dhe te dielave si dhe per qasje sigurie kamera publike qe ka premtu drejtoria perkatese.

**Shaqir Totaj**-Kamerat komuna i blen dhe i vendos mirepo policia e cakton ku me i vendos.

**Engjell Kajtazi**-Ju përshëndes, jeni për lëvdatën trevat ku jetoje une eshte punuar mire.Ju uroje pune te mbare.

**Fadil Berisha**-Ju përshëndes te gjithëve, jam përfaqësues i fshatit Lez,nuk eshte investuar as tash e as me heret ne fshatin Lez.Perderisa ne fshatrat e Przrenit po asfaltohen rruget dytesore ne fshatin Lez nuk eshte investuar asgje.

Kërkesa kryesore është asfaltimi i rruges se fshatit Lez prej Lapidarit sepse eshte ne gjendje te rende 800 m.Rruga e Uck-se eshte nje rruge qe eshte hape me mjete motorrike nga UÇK-ja me 2100m,rregullimi i varrezave te deshmoreve te Lezit,nje problematike qe haset kur keqesohet moti eshte kerkesa per zevendesimin e shtyllave elektrike nga fshati Lybeqeve ne fshatin ne Lez.

**Cele Lamaj-**E kemi bere rehabilitimin e asaj rruge,kemi me bere edhe asfaltimin e rruges.

**Shaqir Totaj-**Edhe nese ska banore ajo rruge e ka rendesine e vet dhe ne momentin kur ka buxhet do ta asfaltojme.

**Shkembim Bytyqi-**Jam kryetar i bashkesise lokale Jeta e Re e kam nje kerkese per drejtorine e shendetesise pse nuk ka dentist lagja Jeta e Re,me heret ka pas mirepo sot nuk ka.Rruga e cila eshte shtru me kubeza sipas banoreve eshte dasht mu shtru ne anen e kunder mirepo ju e keni pa te arsyshme nga ana e tjeter e cila eshte e bllokuar nga mjetet te cilat nuk mundesh me leviz.Si dhe me ndriqim publik jemi manget ne lagjen Jeta e Re.

**Cele Lamaj-**Shume shpejte ne Jeten e Re kam mu nenshkru nje kontrate per fillim e punimeve,kurse per ndriqim publik nese mundemi 30% qdo lokaliteti me ja mundesu ndriqimin publik kemi me qene nje prej komunave me te mira ne nivel Kosove.Nuk ka mundesi buxhetore,jane kosto qe kapin mbi 15 milion euro si vlere,qdo vit investojme 2-2.5 milione.

**Shaqir Totaj-**Lirisht paraqitni problemet se kto jane kerkesa te qytetareve te cilat per neve jane obligim,mirepo buxheti per investime kapitale eshte 25 milione krejt per tere vitin e zakonisht per 1 mandat nuk mundesh me i kry.

**Simir Krasniqi-**Sa i perket pyetjes suaj disa stomatolog jane pensionu dhe shume shpejti pritet te vije nje stomatolog ne Jeten e Re.

**Shkumbin** A ka mundesi ne projektin buxhetin e vitit te ardhshem te parashihet edhe ndertimi i ashensoreve ne banesat kolektive ngase kam 2 apartamente ne Prizren,ka banesa 8 kateshe dhe ka njerez te semure.

**Cele Lamaj-**Ky kuvend para 1 viti ka marr vendim per themelimin e ndermarrjes publike banesore,natyrisht per kete vendim duhet mu mar ministria e ekonomise dhe financave ,eshte dergu gjithe dokumentacioni mirepo ende skemi pergjigje nga ata..nese kemi me vazhdu komuna normal qe merret me lifta dhe mirembajtjen e tyre.

**Herolind Osmanollaj-**Falenderoje kryetarin dhe Cele Lamaj per punen e bere ne fshatin Gjonaj.E kam nje kerkese per rrugen kryesore Gjonaj-Mazrek eshte ne gjendje te mjerushme kerkoje sa ma shpejte te behet nje zgjidhje per ate rruge.

**Bujar Pulaj-**Pershendetje! E kam nje kerkese,te pakten nje ekip ambulantore me pas ne kufi ngase fillon fluksi i madh i mergimtareve edhe fillon turizmi ne restorante ne te cilen kom pa raste qe ka pas nevoje per ekipe ambulantore te shpejta.

**Sabit Bytyqi-**Banoj ne lagjen e Qylhanit e kam nje kerkese per grumbullimin e mbeturinave,jane vetem 3 kosha te cilet nuk mjaftojne nese ka mundesi me caktu edhe nje pike tjeter perballe parkingut me shkarku ate se kompania e pastrimit e pastron 2 here ne dite amo nuk mjafton.Kerkesa tjeter eshte nje kiosk e cila shkakton shume zhurme me muzik nese ka mundesi me largu.

**Xhelal Kukaj**-Ju pershendes te gjitheve.Jam qytetar qe duhet te shpreh shqetesimin tim,une kam prezantuar disa lende,jam perballe me nje lende jo ligjore qe jane prezantu pala dhe autoriteti kontraktues pastaj jam qase ne analizen e edhe te lendeve tjera,ajo ishte keq keto tjerat edhe ma keq.

Isha pale e interesit dhe pale e demtuar,kur u bazova ne rrjedhen e lendeve qdo gje joprofesionale e interpretune dhe e pergaditun.Ne te gjitha lendet ka te meta qe jane per shqyrtim profesional dhe dikush duhet mu pergjegj per ato lende edhe ju jeni te njoftuar.

Psh.Pas gjithe asaj pune qe eshte bere ne Bazhdarhane eshte ndreq ky objekt ne trotuar por sido qe te jete keto probleme nuk guxojne me ndodh ne qytetin tone.

Kjo nuk duhet me ndodhe,nese ndodh nje ngjarje tragjike neser te gjithe jemi me faj.I kam derguar ne add e juaja mirepo eshte injoruar. Kam kerkuar qasje mirepo nuk me eshte dhene asnje pergjigje dhe nuk me eshte ofruar qasja.

Kur te hyhet ne analiza shihet sakte qdo gje,jeni te njoftuar te gjithe.Per ndriqim publik z.Cele Lamaj tha ska pare,nuk eshte qe ska pare por thjesht eshte keq menaxhim.Smart ndriqimi ska shanca me ndodhe,eshte dhene 2 milione e gjysme tenderi dhe asgje nuk eshte bere per smart ndriqim,aty eshte bere veq nje nderhyrje dhe ndrrim te pikave ndriquse egsiztuese qe kan pase garancion 10 vjeqar,jane nderruar ato,eshte demtuar buxheti i yne.

Kjo eshte mungese e seriozitetit ne projektet qe veq egzistojne,projekti ne fjale per ndriqimin publik,cmimet jane te larta dhe nuk ka kuptim logjik pozicionet ne tender,qdo pozicion ka gabime logjike.Pastaj kush e ka bere paramasen,qka ka dashte me shkru,perndryshe kurgjo te sakte ska aty.Prokuroria duhet te veproje menjeher aty dhe personat qe bejne veprime devijante duhet te pozicionohen aty ku e kane vend.

**Shaqir Totaj**-Te falenderohem per diskutim edhe per kyqje,nuk ka cinizem kur them qe nuk jemi perfekt,nuk ka cinizem dhe ska mungese te seriozitetit kur them se jane bere pune te mira.Komuna eshte nje sistem i nderlikuar edhe gjithmone ka nevoje per fedback prej qytetareve per me na ndihmu neve me i identifiku problemet,keshtu qe ju inkurajoj me ardh me be nje takim,jam i intersuar qeto ceshtje me i identifiku mi pa,mi permiresu keto gjera.

Edhe ne jemi ne konkurence me vetveten qfare performance kemi pas para 1 viti,2 viteve apo edhe 3 viteve.Po te isha ne vendin tend do te isha rezervu perpara se me permend fjalen krim,keqmenaxhim apo demtim buxheti...mundesh me dyshu amo smundesh me thene qe ka krim perderisa nuk ka vendim gjyqesor.Ta rekomandoj mu permbajte me keto fjale se jane fjale shume te randa.

Qasja per dokumenta zyrtare ne komunen e Prizrenit ka qene me transparente ne Kosove,nuk ka pas raste qe nuk i kemi kthyer dikujt pergjigje,gjithmone do ta kete pergjigjen amo mvaret a ju pelqen a jo.Secili duhet me i ndihmu njeri tjetrit,Prizreni eshte i te gjitheve edhe komuna eshte e te gjitheve.Mendimi kritik me qellim te mire eshte ajo qe e shtyn perpara sistemin.

**Simon Veseli**-Ne raportin e kryetarit per Velezhe u permenden 2 ura qe jane ne ndertim e siper,e kam bere nje kerkese ne janar per 3 ura,2 jane realizu.Nuk e di pse 1 nuk eshte kry edhe pse punekryesi ne teren thote se do ti kryeje 3 pune ne Velezhe.E di qe ska buxhet por ne Velezhe ka mjafte kerkesa.Nje kerkese e kam dorezu ne DSHP me intereson me dite deri kur mundet te realizohen keto kerkesa.

**Cele Lamaj**-Nese kemi me pas mundesi buxhetore do te fillojne punimet.Besoni se nuk ka mjete edhe operatoret jane tu vepru me mirekuptim.

**Ridvan Zenelaj**-Po flas ne emer te disa pronareve te tokave,pas pompes se Kag Asphaltit.Ato prona jane te klasit te 5 dhe te 6. Edhe jane te dedikuar per bujqesi mirepo nuk perdoren per bujqesi.Kerkesa eshte te shnderrohet per industri sepse eshte pengese.E kam bere nje kerkese mirepo mu ka leju veq per 200 kuadrat.Eshte nje ndihme e madhe.

**Shaqir Totaj**-Me heret e permenda fazen e finalizimit te planit zhvillimor te Prizrenit, i cili e parasheh ne 10 vitet e ardhshme qfar drejtimi ka mu zhvillu qyteti i Prizrenit,ju rekomandoj kur te kemi konsultime publike me ekipin qe mirret me hartimin dhe zhvillimin e planit komunal te vini dhe ti paraqitni ato kerkesa.

**Takimi ka përfunduar në orën:10:54**

Në këtë vegëz: https://www.facebook.com/share/v/19TuWJFENG/ , mund ta gjeni video incizimin e takimit.

Procesmbajtës:

Haziz Krasniqi



# NJOFTIM PUBLIK

**Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit për organizimin e takimit të parë publik.**

**Data : 30.06.2025**

**Vendi: Salla e mbledhjeve e Kuvendit Komunal të Prizrenit (Shtëpia e Bardhë).**

**Ora : 09:00**

**Të dashur qytetarë/e,**

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 92 të Statutit të Komunës së Prizrenit me Nr. 01/011-5643, Udhëzimi Administrativ MAPL Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës dhe Rregulloren 01/2025 për Transparencë në Komunën e Prizrenit, në bashkëpunim me Njësinë për Komunikim me Publikun, bën:

**NJOFTIMIN PËR TAKIMIN E PARË PUBLIK TË KRYETARIT**

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit, OJQ-të dhe palët tjera të interesuara, se Kryetari i Komunës së Prizrenit, z. Shaqir Totaj, organizon takimin e parë publik me qytetarë për punën e tij në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2025.

Takimi Publik mbahet më **30.06.2025** (e Hëne) në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit ( Shtëpia e Bardhë ), me fillim në orën **09:00.** Në këtë takim do të keni mundësinë të njiheni me punën e qeverisë komunale për gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2025.

Takimi është i hapur dhe qytetarët mund t'i parashtrojnë pyetje kryetarit dhe ekzekutivit të Komunës për të gjitha temat të cilat atyre ju interesojnë.

Të drejt pjesëmarrjeje kanë të gjithë qytetarët e komunës së Prizrenit.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri me datën:**27.06.2025** në ora **16:00**, në emailat:

Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

Raportet e kryetarit të komunës mund ti gjeni të publikuar në këtë vegëz: https://prizren.rks-gov.net/raportet-e-kryetarit/

Ymer Berisha

Udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 355/25 Dt. 16.06.2025

KOMUNA - OPŠTINA - BELEDIYE
• PRIZREN •



# JAVNO OBAVEŠTENJE

**Obaveštavaju se svi građani opštine Prizre o organizovanju javnih konsultacija.**

**Dana: 30.06.2025**

**Mesto: Sala Skupštine opštine (Bela Kuća).**

**Vreme: 09:00**

**Poštovani građani e,**

Na osnovu Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu Samoupravu, član 92 Statuta opštine Prizren br. 01/011-5643, Administrativno Uputstvo MALS br. 04/2023 za Otvorenu Administraciju u opštinama, gradonačelnik opštine, u saradnji sa Jedinicom za komunikaciju sa javnošću, vrši:

## OBAVEŠTENJE ZA PRVI JAVNI SASTANAK GRADONAČELNIKA

Obavještavaju se svi građani opštine Prizren, nevladine organizacije i druge zainteresovane strane da je gradonačelnik opštine Prizren g. Shaqir Totaj, organizuje prvi javni sastanak sa građanima za svoj rad u prvih šest (6) mjeseci 2025. godine.

Javni sastanak će se održati **30.06.2025** ( Ponedjeljak) u sali za sednice Skupštine opštine Prizren (Bela kuća), sa početkom od **09:00** časova. Na ovom sastanku imaćete priliku da se upoznate sa radom opštinske vlasti za prvih šest (6) meseci 2025. godine.

Sastanak je otvoren i građani mogu uputiti pitanja gradonačelniku i izvršnoj vlasti opštine o svim temama koje ih zanimaju.

Pravo učešća imaju svi građani opštine Prizren.

Komentare i sugestije možete slati do **27.06.2025** u **16:00**, na mejlove službenika:

Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net i Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

Na ovoj stranici možete pronaći izvještaje gradonačelnika: https://kk.rks-gov.net/prizren/staff/shaqir-totaj/#raporti_main

Ymer Berisha

Rukovodilac Jedinice za Odnose sa Javnošću

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 355/25 Dt. 16.06.2025

KOMUNA - OPŠTINA - BELEDİYE
PRIZREN



# KAMU BİLDİRİSİ

**İlk kamu toplantının düzenleneceği tüm Prizren Belediye sakinlerine duyurulur.**

**Tarih : 30.06.2025**

**Yer: Belediye Meclis toplantı salonunda (Beyaz Ev)**

**Saat : 09:00**

Sevgili vatandaşlar,

03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un, 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğün 92. Maddesi, Belediyelerde Açık Yönetim ile ilgili 04/2023 sayılı İdari Yönergeye (YYB) istinaden Belediye Başkanı, Halkla İlişkiler Birimi ile işbirliğinde aşağıda yer alan duyuruyu ilan etmektedir:

**BAŞKAN'IN İLK HALKLA KAMU TOPLANTISI İÇİN DUYURU**

Tüm Prizren Belediyesi sakinleri, STK'lar ve diğer ilgili taraflar, Prizren Belediye Başkanı Sn. Shaqir Totaj, 2025 yılının ilk altı (6) aylık çalışmaları ile ilgili ilk halkala kamu toplantısı düzenleyeceği duyurulur.

Söz konusu kamu toplantısı **30.06.2025** (Cuma günü) tarihinde saat **09:00** başlamak üzere Prizren Belediye Meclisin toplantı salonunda (Pazartesi) düzenlenecektir. Bu toplantıda belediye yönetiminin 2025 yılının ilk altı (6) ayına yönelik çalışmaları hakkında bilgi edinme fırsatına sahip olacaksınız.

Toplantı halka açıktır ve vatandaşlar kendilerini ilgilendiren tüm konularda belediye başkanına ve belediye yöneticilerine sorularını iletebilmektedir.

Prizren Belediyesinin tüm sakinleri katılım hakkına sahiptir.

Yorum ve önerilerinizi **27.06.2025** tarihinde saat **16:00** kadar Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net ve Haziz.Krasniqi@rks-gov.net yetkililerin e-posta adreslerine iletebilirsin.

Belediye Başkan'ın raporlarını https://prizren.rks-gov.net/raportet-e-kryetarit/ burada bulabilirsiniz.

Ymer Berisha

Halkla İletişim Birim Yöneticisi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 355/25 Dt. 16.06.2025

KOMUNA - OPŠTINA - BELEDIYE
PRIZREN



# PUBLIKUNO PENJARIPE

**Penjargyona sah Prizrenoska Komunake dizune vash organizipe e anglune publikune kedipasko.**

**Data : 30.06.2025**

**Than: Prizrenoska Komunaki Sombeshipaski kedipyengi sala (Parno Kher).**

**Ora : 09:00**

**Kamle dizune,**

Baziripea pe Krisi Gn. 03/L-040 vash Lokaluno Korkororaipe, e artiklosko 92 e Prizrenoska Komunake Statutesko e Gn. 01/011-5643, Administrativuno Godideipe MALG Gn.04/2023 vash Puterdi Administracia ano komune, pe ledeipe e Sekcia vash Komunikipe e Publika, kerla:

**PENJARIPE VASH ANGLUNO PUBLIKUNO KEDIPE E SHERUNEA**

Penjargyona sah o dizune e Prizrenoska Komunako, BRO thay yave rintereseske riga, kay Prizrenoska Komunako Sheruno, r. Shaqir Totaj, organizinla angluno publikun kedipe e dizunenca vash oleski buti vash anglune shov (6) masek e bershesko 2025.

Publikuno kedipe adikergyola pe **30.06.2025** (Lumiako Dive) ani kedipyengi sala e Prizrenoska Komunake Sombeshipasko (Parno Kher), shrdipea pe ora **09:00.** Ko akava kedipe ka oveltumen shaipe te penjargyoven e butya koya kerdili kotar komunaluno raipe vash angluno shov (6) masekuno periodi e bershesko 2025.

O kedipe si phravdo thay o dizune shay te thoven olenge puqipya Komunake sheruneske thay ekzekutiveske vash sah o teme kola intereseinane olen.

Hako vash kotorleipe silen savore Prizrenoska komunake dizune.

Tumare komentya thay sugestie, shay te biqhalen ji pe data:**27.06.2025** pe ora **16:00**, ko emailya:

Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net thay Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

Komunake sheruneske raportya shay te arakhen ko akava link: https://prizren.rks-gov.net/raportet-e-kryetarit/

Ymer Berisha

Phiravno e Sekciako vash Komunikipe e Publika

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 355/25 Dt. 16.06.2025



# PUBLIC NOTICE

**All citizens of the Municipality of Prizren are hereby notified of the organization of the first public meeting.**

**Date: 30.06.2025**

**Venue: The meeting hall of the Municipal Assembly of Prizren (White House).**

**Time: 09:00 AM**

**Dear citizens,**

Based on the Law No. 03/L-040 on Local Self-Government, Article 92 of the Statute of the Municipality of Prizren No. 01/011-5643, Administrative Instruction MLGA No. 04/2023 on Open Administration in Municipalities, the Mayor of the Municipality, in cooperation with the Municipal Information Office, hereby issues this:

**NOTICE ON THE FIRST PUBLIC MEETING OF THE MAYOR**

All citizens of the Municipality of Prizren, NGOs and other interested parties are hereby notified of the first public meeting with citizens by the Mayor of the Municipality of Prizren, Mr. Shaqir Totaj, on his work during the first six (6) months of 2025.

The Public Meeting is scheduled for **30.06.2025** (Monday) in the meeting hall of the Assembly of the Municipality of Prizren (White House), starting at **09:00.** At this meeting, you will have the opportunity to learn about the work of the municipal government for the first six (6) months of 2025.

The meeting is open, and citizens can submit questions to the mayor and the executive of the municipality on all topics of interest.

All citizens of the municipality of Prizren are entitled to participate.

Please submit your comments and suggestions by: **27.06.2025** at **16:00**, via emails:

Adelina. Hoxhaj@rks-gov.net and Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

You can find the mayor's reports published on this page: **https://prizren.rks-gov.net/raportet-e-kryetarit**

Ymer Berisha

Head of the Municipal Information Office

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 355/25 Dt. 16.06.2025

Republika e Kosovës

Republika Kosova

Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren

Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në takimin e parë publik me qytetarë për punën e tij në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2025.

**Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.**

Data e mbajtjes së takimit: **30.06.2025**.

| Nr. | Emri Mbiemri | Ne.Tel | Email | Gjinia | Përkatësia etnike | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SHKËMBIN Bytyqi | [redacted] | [redacted] | M | SHQIPTAR | |
| 2 | FISNIK MINCI | / | / | M | Sh | |
| 3 | Salih Bytyqi | [redacted] | [redacted] | M | Sh. | |
| 4 | SHKUMBIN DELLIQI | [redacted] | [redacted] | M | SH | |
| 5 | BESARTA GASHI | | | F | | |
| 6 | HAZIR KRASNIQI | | | M | | |
| 7 | Hasime Bytyqi | | | F | | H. B |
| 8 | HAJRIE GASHI | | | F | | HAJIE. G |
| 9 | Mehreme Gagovi | | | F | | M. G |
| 10 | DRITON B. SIQECA | | | M | | |
| 11 | Osman Osmonaj | | | M | | |
| 12 | Dafina Ukallo | [redacted] | | F | | |
| 13 | Arlinda Rama | [redacted] | | F | | |
| 14 | Ramize Shala | | | F | | R. Shala |
| 15 | AGNESA HOXHA | | | F | | A. Hoxha |

Republika e Kosovës

Republika Kosova

Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren

Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në takimin e parë publik me qytetarë për punën e tij në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2025.

**Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.**

Data e mbajtjes së takimit: **30.06.2025**.

| Nr. | Emri Mbiemri | Ne.Tel | Email | Gjinia | Përkatësia etnike | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ramadan BERISO | [redacted] | — | M | PRIZREN | [signature] |
| 2 | Flurije Omej | [redacted]36 | | F | Prizren | |
| 3 | SUZANA KRASNIQI | 044-887-1[redacted] | - | F | PRIZREN | [signature] |
| 4 | Gjek Kolmekaj | 04[redacted]24 605 | | M | | [signature] |
| 5 | Rifat Zenelaj | 0[redacted]53[redacted] | — | M | SHQIPTAR | [signature] |
| 6 | AGRON KAJDOMAJ | 04924[redacted] | | M | SHQIPTAR | [signature] |
| 7 | PELIVAN PULAJ | [redacted]39 | — | M | SHQIPTAR | [signature] |
| 8 | Bujar Pulaj | 04[redacted]27 | | M | Shqiptar | [signature] |
| 9 | ALMIR BAJRAMI | 04[redacted]7 | | M | BOSNJAK | [signature] |
| 10 | Simon Vodli | 044119[redacted]49 | | M | Shqiptar | [signature] |
| [redacted] | Fejsal Hoti | 044[redacted] | | M | Shqiptar | [signature] |
| 12 | XHELAL LUKAJ | [redacted]3790 700 | | M | | [signature] |
| 13 | ISGJAM SALIHI | 04[redacted] | — | M | Ko | [signature] |
| 14 | Merita Shala | [redacted] | [redacted] | F | Shqiptare | [signature] |
| 15 | JEHONA SELIMI | [redacted]9.52[redacted]657 | [redacted]selimi@gma[illegible] | F | SHqiptar | [signature] |

Republika e Kosovës

Republika Kosova

Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren

Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në takimin e parë publik me qytetarë për punën e tij në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2025.

**Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.**

Data e mbajtjes së takimit: **30.06.2025**.

| Nr. | Emri Mbiemri | Ne.Tel | Email | Gjinia | Përkatësia etnike | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bajrame Tafalleri | [redacted] | | F | shqiptare | [illegible] |
| 2 | Fadil Berisha | [redacted] | fadil[redacted]r.[redacted] | [redacted] | shqiptarë | [illegible] |
| [redacted] | Engjell Kojtari | 049/805[redacted]6 | / | M | —//— | [illegible] |
| 4 | [illegible] | 044-5[redacted] | —7 | M | —//— | [illegible] |
| 5 | SABIT [illegible] | [redacted] | [redacted]ca | M | Shqiptar | [illegible] |
| 6 | Lulzim Drini | [redacted]7[redacted] | ip[redacted]@gmail.com | M | shqiptar | [illegible] |
| 7 | ARBËR KURTAJ | 04543[redacted]06 | [redacted]-gov.net | M | SHQIPTAR | [illegible] |
| 8 | Tuulant Mujo | [redacted]44 900944 | [redacted]v.net | | shqiptar | [illegible] |
| 9 | HERZHAD OSMANOLLAJ | [redacted] | [redacted] | M | SHQIPTAR | [illegible] |
| 10 | ABAZ BODAJ | [redacted] | [redacted]H | M | ^ | [illegible] |
| 11 | Imer Hoxha | [redacted] | [redacted] MALËSI E RE | F | SHQIPTAR | Imer Hoxha |
| 12 | PRANVERË ASLLANI | [redacted] | [redacted] | M | SHQIPTAR | [illegible] |
| 13 | [illegible] | [redacted] | [redacted] | F | [illegible] | [illegible] |
| 14 | [illegible] | [redacted] | [redacted] | M | [illegible] | [illegible] |
| 15 | | | [redacted]LUSH KRUSHA | M | | |

Republika e Kosovës

Republika Kosova

Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren

Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në takimin e parë publik me qytetarë për punën e tij në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2025.

**Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.**

Data e mbajtjes së takimit: **30.06.2025**.

| Nr. | Emri Mbiemri | Ne.Tel | Email | Gjinia | Përkatësia etnike | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Sefer Soligji | [redacted] | — | M | | [illegible] |
| 2 | Jetmira Gali | | | F | | [illegible] |
| 3 | [illegible] | | | M | | [illegible] |
| 4 | [illegible] | | | F | | [illegible] |
| 5 | [illegible] Gërdella | | | M | | [illegible] |
| 6 | | | | | | |
| 7 | | | | | | |
| 8 | | | | | | |
| 9 | | | | | | |
| 10 | | | | | | |
| 11 | | | | | | |
| 12 | | | | | | |
| 13 | | | | | | |
| 14 | | | | | | |
| 15 | | | | | | |